



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

19-020/04-85616/22, më 19-04-2022

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31/15, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARËS NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE KOMUNALE "PALLATI I RINISË" SH.A.

- I. Mimoza Sylejmani, caktohet anëtare në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike të Komunës së Prishtinës "Pallati i Rinisë" Sh. A.
- II. Anëtarja e cekur në pikën I të këtij vendimi së bashku me dy anëtarët të cilët i emëron Kuvendi i Komunës e përbëjnë komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen komunale "Pallati i Rinisë" Sh. A.
- III. Anëtarja e komisionit komunal të aksionarëve, e caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Komunës.
- IV. Veprimet e anëtares të komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtares;
- NPL "Pallati i Rinisë" sh.a.
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS

Përparim Rama

